

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORTI MBI MISIONIN

Vizualizimi i statistikave duke përdorur softverin GIS

Komponenti nr. 4.3.2

Misioni i udhëhequr nga
Troels Aksel Vestergaard, Statistikat e Danimarkës

18-20 Gusht 2015

IPA 2012

Emri, adresa, emaili i autorit

*Troels Aksel Vestergaard
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173933:
Email: tav@dst.dk*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentë të përgjithshme.....	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	7
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	9
Aneksi 2. Personat e takuar	12
Aneksi 3. Modeli për adresat sistematike.....	13
Aneksi 4. Pyetësi përfshirë dy llojet e adresave (kodi dhe emri).....	14
Aneksi 5. Shembull i hartës GIS për të siguruar mbledhjen e saktë të adresave sistematike.....	15
Aneksi 6. Shembull praktik i funksionit të GIS.....	16
Aneksi 7. Shembull i "Profili i komunave".....	17

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e Referencës
GIS	Sistemi i Informatave Gjeografike

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është aktiviteti i dytë në projekt, që i dedikohet punës me Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS). Misioni kishte për qëllim definimin e një plani strategjik, që do të përbënte bazën për implementimin e mëtejshme të projektit në këtë fushë.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

Aktiviteti 4.3.2b:

- Rishikimi i detajuar i përdorimit aktual dhe në të ardhmen isoftverit GIS për diseminimin në ASK
- Krijimi i një harte rrugore dhe dakordimi mbi strategjinë për përdorimin e GIS në vitet e ardhshme
- Përmblidhja e programit të dakorduar në Kopenhagë

Konsulenti dëshiron të falenderojë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tij gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentit dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet – Sistemi i Informacionit Gjeografik

Aktiviteti 4.3.2b do të sigurojë keto rezultate:

Funksionalitetet e të punuarit me softverin GIS. ASK-ja e ka të qartë rrjedhën e punës për sa i përket të dhënave hapësinore, si dhe strukturës përkatëse të kodeve.

Misioni i dytë në këtë komponent filloi duke analizuar gjendjen dhe punën e bërë me GIS në ASK dhe me punë praktike lidhur me këtë temë. Fokusi ishte në adresat, projeksionet dhe diseminimin e të dhënave hapësinore. Gjatë vizitës së zyrtarëve të ASK-së në Statistikat e Danimarkës në qershor 2015 dhe prezantimit të bërë atëherë nga Shefi i Divizionit Michael Berg Rasmussen, u përpilua edhe programi për këtë mision. Në përpilimin e programit gjithashtu morën pjesë Z. Burim Limolli, Shef i Divizionit të TI-së dhe Z. Idriz Shala, ekspert i GIS, si dhe Z. Troels Vestergaard, Shefi i Divizionit nga Statistikat e Danimarkës dhe Z. Per Knudsen nga projekti.

Programi:

1. Si janë të strukturuar adresat në Statistikat e Danimarkës dhe si të implementohet niveli i njëjtë i strukturës në ASK
2. Roli i Statistikave të Danimarkës në infrastrukturën e të dhënave kombëtare hapësinore
3. Metadat e GIS në Statistikat e Danimarkës
4. Punë praktike me GIS mbi përdorimin e të dhënave hapësinore

Analizimi i këtyre katër fushave të rëndësishme për të shkuar drejt publikimit të statistikave më të sakta duke përdorur sistemin GIS dhe sigurimi i metadatave të sakta në diseminimin e hartave GIS ishin objektivat kryesore të misionit të dytë. Gjatë misionit, u theksuan dallimet dhe ngjashmëritë midis ASK-së dhe Statistikave të Danimarkës, sidomos lidhur me sistemin e adresave dhe rolin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore.

1/

Sesioni filloi me prezantimin se si trajtohet sistemi i adresave në Statistikat e Danimarkës.

Për misionin e dytë, Statistikat e Danimarkës kanë përgatitur një dosje sistematike të adresave, që iu dorëzua ASK-së për të parë se si janë të rregulluara adresat dhe gjithashtu cilat janë kodet e nevojshme për krijimin e dojeve GIS, shih aneksin 3:

Kodikomunës_kodirrugës_numrishtëpisë dhe koordinatat X,Y

ASK-ja ka një bashkëpunim të mirë me Agjencinë e Hartave dhe Kadastrale të Kosovës dhe marrja e të dhënave nga ta me qëllim të pasjes së adresave sistematike në GIS nuk është e vështirë por në këtë drejtim për ASK-në do të ishte e dobishme një qasje sistematike. ASK-ja do të analizojë më tej çështjen e regjistrimit të adresave në agjencinë e hartave.

ASK-ja dhe Statistikat e Danimarkës kanë rënë dakord që adresat sistematike në ASK duhet të organizohen sipas mënyrës së përshkruar.

Gjithashtu, u demonstrua një shembull se si mund të përdoren të dhënat sistematike për qëllime statistikore kur kombinohen me të dhëna nga regjistri, siç ekziston mundësia në Statistikat e Danimarkës – me realizimin e regjistrimit do të duhej të ekzistonte kjo mundësi për ASK-në, natyrisht në varësi nga niveli i të dhënave nga regjistrimi, por metodologjia e gjo-tëdhënave dhe pjesa e metadatave është në masë të madhe e njëjtë midis ASK-së dhe Statistikave të Danimarkës.

Të dy përfaqësuesit, nga Agjencia e Statistikave të Danimarkës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndajnë mendimin që adresat sistematike janë forma më efikase dhe rrisin cilësinë e punës me informacione gjeografike në përgjithësi, sidomos nëse kombinohen me burime të tjera të të dhënave. Kjo gjithashtu do ti ndihmojë ASK-së të punojë në dy drejtime të ndryshme (kombëtare dhe në nivel të BE). Për shkak të situates, ASK-ja dhe Statistikat e Danimarkës kanë projeksione të ndryshme.

Është më e saktë dhe ofron më shumë mundësi sistemi i adresave sistematike sipas direktivës INSPIRE. P.sh. të dhënat mund të përmbushin kërkesat të përshkruara në INSPIRE duke përdorur projeksionet e BE-së, por gjithashtu edhe për qëllime kombëtare. Është e rëndësishme që të jetë e qartë se cilat kur dhe për çfarë qëllimesh përdoren metadatat e caktuara.

Procesi i zhvillimit të adresave të GIS në adresa sistematike mund të sigurohet duke bërë disa përshtatje në regjistrimin nga ASK-ja. Ky përmirësim tashmë po realizohet nga ASK-ja.

Ky proces mund të bëhet duke përdorur të dy adresat duke siguruar kështu adresat sistematike për analiza të GIS. Gjithashtu, janë bërë hartat për të siguruar që gjatë regjistrimit përdoren adresat e sakta sistematike, shih aneksin 5. Kjo do ti ndihmonte regjistrimit të vendosë të dyja

adresat në secilën adresë, në nivel të derës kryesore. Një gjë e tillë do të ishte e dobishme për zhvillimim e mëtejshëm të GIS dhe të dhënave hapësinore në përgjithësi.

Përparësitë e adresave sistematike janë që mirëmbahen dhe azhurnohen më lehtë dhe janë më të sakta, sidomos me kalimin e kohës. Gjithashtu, janë shumë të dobishme për të punuar me të dhëna nga regjistri. Pasja e adresave sistematike, të lidhura me një nivel të caktuar gjeografik p.sh. koordinatat X dhe Y, mund të konsiderohen të dhëna publike dhe të përdoren për gjithë sektorin publik dhe jo vetëm për qëllime statistikore, siç është në rastin e Statistikave të Danimarkës.

2/

Eksperti nga Statistikat e Danimarkës shpjegoi rolin e tyre në infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore në Danimarkë.

Në rastin e adresave, doli në pah që sistemi danez dhe ai i Kosovës janë mjaft të ngjashëm. Komunitet janë përgjegjëse për adresat dhe ato mbledhim të dhënat në nivel lokal dhe i dorëzojnë ato në agjencinë e hartave dhe kadastrale. Prandaj, roli i dy agjencive është i ngjashëm në të dy vendet. Gjithashtu, në të dy vendet, ekziston një komunikim i mirë midis agjencive publike.

3/

Çështja e metadatave gjithashtu është e ngjashme në të dy vendet. Eksperti nga Statistikat e Danimarkës shpjegoi dy llojet e projeksioneve dhe prodhimin e hartave me legjendat përkatëse. Për qëllime ndërkombëtare (BE), përdoret standardi ERTS89.

Për të dhënat e paraqitura, duhet të ketë metadata të mjaftueshme për temat, ndërkohë që sistemi GIS automatikisht shton të dhënat hapësinore. Eksperti nga ASK-ja paraqiti të dhënat, që lidhen me statistikën sociale, duke treguar se si të dhënat hapësinore dhe metadata plotësojnë njëra tjetrën duke krijuar një pasqyrë të përgjithshme mbi fushën/temën.

4/

Çështja e katërt u trajtua në formë të punës praktike duke krijuar një hartë, ku paraqiten buferët dhe kalkulimi i distancës midis adresës dhe spitalit më të afërt, si dhe kalkulimi i numrit të banorëve brenda një rrezeje të caktuar të një objekti, në këtë rast të spitalit. Gjatë këtij aktiviteti u pa nevoja për adresa më të sakta por metodologjia në GIS është e njëjtë dhe mund të shpërndahet lehtësisht në ASK, shih aneksin 6.

3. Konkluzione dhe rekomandime

ASK-ja ka kapacitete shumë të mira për GIS. Dhe fusha e të dhënave hapësinore jep mundësi për disa publikime shumë interesante mbi statistikat hapësinore.

Rekomandimet lidhur me GIS

Pas misionit, rekomandohen këto aktivitete:

- Të vazhdohet me nivelin e lartë të publikimeve bazuar në GIS
- Publikimet online të “Profilin e komunave” ose të ngjashme në faqen e internetit të ASK-së, një shembull paraqitet në aneksin 7

- Të sigurohet pjesëmarrja në forumin ndërkombëtar: Forumi evropian për Gjeografi dhe Statistika (EFGS) – sidomos për metadat
- Në bashkëpunim me agjencinë e hartave dhe kadastrale, të krijohet regjistri i adresave

Eksperti rekomandon që ASK-ja të përdorë një projeksion për GIS kombëtar dhe standardin e BE-së ERTS89 për kërkesa të BE-së.

Eksperti rekomandon që adresat sistematike në ASK duhet të organizohen sipas modelit të përshkruar dhe paraqitur në aneksin 3.

Eksperti rekomandon që këto përpjekje në nivel gjeografik të implementohen gjatë regjistrimit të ardhshëm, shih aneksin 4.

Përparësitë e adresave sistematike:

Lokacionet e adresave për ndërtesat do të ndihmojnë informacionet statistikore gjeo-referente

Nevoja për përmirësimin e cilësisë së regjistrimeve në Kosovë

Shtytja e intervistuesve për anketa të tjera statistikore

Vizualizimi i rezultateve të regjistrimit në harta

Veprimi	Afati kohor	Përgjegjësi
1. Adresat sistematike në sistemin GIS në ASK	T 3-4 2015 (varësisht nga marrja e të dhënave)	ASK
2. Analizat e përmbajtjes GIS	T 3-4 2015 (varësisht nga marrja e të dhënave)	ASK
3. Publikimi i „Profilit të komunave”	T 4 2015 (varësisht nga marrja e të dhënave)	ASK
4. Adresat sistematike në regjistrime	Në proces	ASK
Azhurnimi dhe mirëmbajtja e adresave sistematike	Në process	ASK

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit BE-së KS12 IB ST 01 Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 4: Sistemi i Teknologjisë Informative dhe Diseminimi
Aktiviteti 4.3.2b: Vizualizimi i statistikave duke përdorur softverin GIS

Afatet kohore:

TeR –të gatshme: 26 Qershor 2015
Fillimi/ përfundimi: 17-20 Gusht 2015
Raportimi: 3 Shtator 2015

Rezultati obligativ i komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi	Standardi	Burimet e informacioneve	Supozimet
Rezultati obligativ 4.2	Zhvillimi i Diseminimit përmes faqes së internetit	- Web faqja e ASK dhe përmirësimi i përdorimit të saj, deri në tremujorin e 8-të të projektit - Databaza e diseminimit, e instaluar dhe në dispozicion deri në tremujorin e 7-të të projektit. - Raporti i misionit, i vendosur në webfaqen e projektit - Diskutimi i rekomandimeve për punën në të ardhmen dhe azhurnimi i planit të punës	- Web faqja e ASK - Databaza e Diseminimit - Raportet Tremujore të Binjakëzimit - Raportet e Misioneve	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Funksionimi i teknologjisë së TI - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes te misioneve

Tema /qëllimi i aktivitetit: 4.3.2b

Ky mision është vazhdim i misionit 4.3.2a, që u realizua në Janar 2015. Gjatë këtij misioni më tej do të diskutohet për përdorimin e softverit GIS për të përmirësuar diseminimin nëpërmjet wefaqes. Gjithashtu, do të jepen rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të GIS në ASK.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 4.3.2b

Aktiviteti 4.3.2b do të sigurojë keto rezultate:

Raporti i misionit me vështrim mbi përdorimin aktual dhe të ardhshëm të softverit GIS për diseminim në ASK dhe rekomandimet për punën në të ardhmen. ASK-ja do ta informojë ekspertin lidhur me përdorimin aktual të GIS në ASK..

Eksperti i vendeve anëtare do të informojë ASK-në në lidhje me gjendjen në vendet anëtare dhe strategjitë mbi GIS dhe planet e Eurostat-it për këtë çështje.

Përfaqësuesit e ASK-së dhe të vendeve anëtare do të rishikojnë hartën rrugore dhe dakordohen rreth strategjisë për përdorimin e GIS në vitet e ardhshme.

Përfaqësuesit e ASK-së dhe të vendeve anëtare do të diskutojnë mundësitë për ripërdorimin e të dhënave për GIS bazuar në databankën sapo të instaluar: Ask KAS

Stafi i ASK-së:

1. Z. Burim Limolli, Shef i TI-së, burim.limolli@rks-gov.net, ASK
2. Z. Idriz Shala, Ekspert i GIS, idriz.shala@rks-gov.net, ASK

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Eksperti i vendeve anëtare:

Z. Troels Vestergaard, Shef Sektori, Statistikat e Danimarkës, tav@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, zogaj.nora@gmail.com

Historiku

Raporti AGA i vitit 2012 deklaroi që është shumë e nevojshme të përmirësohet web faqja e ASK-së, për ta bërë më të lehtë për përdoruesit dhe një mjet më fleksibil të diseminimit.

Në përgjithësi aktivitetet në kuadër të komponentit 4 do të adresojnë këto çështje:

- Përmirësimi i diseminimit përmes web faqes i statistikave të caktuara, duke përfshirë përmirësimin e web faqes së ASK-së dhe duke e bërë atë më të lehtë për ta përdorur dhe mjet më fleksibil diseminimi;
- Zhvillimi i udhëzuesve për dizajnimin e tabelave dhe grafikëve, që po ashtu të përdoren për diseminim përmes web faqes;
- Zhvillimi i databazës së diseminimit, përfshirë metadata më të kompletuara që mbulojnë aspekte të ndryshme, që lidhen me cilësinë e të dhënave;
- Zhvillimi i strategjisë dhe rekomandimeve për statistikave, të vizualizuara gjeografikisht
- Plani i punës i azhurnuar për implementimin e databazës së diseminimit.
- Përshkrimi i rrjedhës së punës dhe ndarja e punëve midis TI-së, diseminimit statistikantëve të fushave përkatëse

Aktivitetet, që realizohen si përgatitje për misionin:

Sigurimi i dokumenteve relevante

- Raportet mbi misionet në komponentin 4 (të gjitha në faqen e internetit dst.dk/Kosovo)

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09:30	Hyrje në këtë pjesë të komponentit 4
		09:45	ASK do të prezantojë para ekspertit gjendjen aktuale të përdorimit të GIS në ASK
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Plani për javën
		11:30	Dreka
		13:00	Eksperti i vendeve anëtare- GIS në Statistikat e Danimarkës- organizimi i punës dhe burimet e të dhënave
		14:30	Pushim për kafe
		15:00 – 16:00	Punë praktike me GIS
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me GIS
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me GIS
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me GIS Dakordimi për rekomandimet, afatet kohore, dhe punën që duhet të realizohet nga ASK në fushën e GIS Shkrimi i raportit Takim: Eksperti, udhëheqësi i komponentit, udhëheqësi i projektit në ASK, RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

1. Z. Idriz Shala, ekspert i GIS, idriz.shala@rks-gov.net, ASK

Ekipi i projektit:
Per Knudsen, RTA
Nora Zogaj

Aneksi 3. Modeli për adresat sistematike

<u>Adrkode</u>	<u>Adresse</u>	<u>zip-code</u>	<u>Distrikt</u>	<u>X</u>	<u>Y</u>
1010004001	Abel Cathrines Gade 1	1654	København V	723723	6175309
1010004003	Abel Cathrines Gade 3	1654	København V	723735	6175304
1010004003A	Abel Cathrines Gade 3A	1654	København V	723743	6175322
1010004006	Abel Cathrines Gade 6	1654	København V	723773	6175266
1010004007	Abel Cathrines Gade 7	1654	København V	723757	6175294
1010004008	Abel Cathrines Gade 8	1654	København V	723786	6175261
1010004009	Abel Cathrines Gade 9	1654	København V	723764	6175297
1010004010	Abel Cathrines Gade 10	1654	København V	723793	6175257
1010004011	Abel Cathrines Gade 11	1654	København V	723769	6175309
1010004012	Abel Cathrines Gade 12	1654	København V	723803	6175253
1010004014	Abel Cathrines Gade 14	1654	København V	723814	6175249
1010004016	Abel Cathrines Gade 16	1654	København V	723829	6175242
1010004018	Abel Cathrines Gade 18	1654	København V	723872	6175223
1010004021	Abel Cathrines Gade 21	1654	København V	723818	6175267
1010004021A	Abel Cathrines Gade 21A	1654	København V	723818	6175276
1010004021B	Abel Cathrines Gade 21B	1654	København V	723823	6175288
1010004023	Abel Cathrines Gade 23	1654	København V	723832	6175260
1010004025	Abel Cathrines Gade 25	1654	København V	723841	6175257
1010004026	Abel Cathrines Gade 26	1654	København V	723926	6175199
1010004027	Abel Cathrines Gade 27	1654	København V	723851	6175252
1010004029	Abel Cathrines Gade 29	1654	København V	723893	6175234
1010004031	Abel Cathrines Gade 31	1654	København V	723907	6175228
1010004033	Abel Cathrines Gade 33	1654	København V	723919	6175223
1010008003	Abildgaardsgade 3	2100	København Ø	724706	6177477
1010008004	Abildgaardsgade 4	2100	København Ø	724715	6177496
1010008005	Abildgaardsgade 5	2100	København Ø	724701	6177480
1010008006	Abildgaardsgade 6	2100	København Ø	724709	6177500
1010008007	Abildgaardsgade 7	2100	København Ø	724696	6177484
1010008008	Abildgaardsgade 8	2100	København Ø	724705	6177503
1010008009	Abildgaardsgade 9	2100	København Ø	724691	6177487
1010008010	Abildgaardsgade 10	2100	København Ø	724700	6177506
1010008011	Abildgaardsgade 11	2100	København Ø	724686	6177491
1010008012	Abildgaardsgade 12	2100	København Ø	724695	6177509
1010008013	Abildgaardsgade 13	2100	København Ø	724681	6177494
1010008014	Abildgaardsgade 14	2100	København Ø	724689	6177513
1010008015	Abildgaardsgade 15	2100	København Ø	724676	6177497
1010008016	Abildgaardsgade 16	2100	København Ø	724685	6177516
1010008017	Abildgaardsgade 17	2100	København Ø	724671	6177500
1010008018	Abildgaardsgade 18	2100	København Ø	724679	6177520

Aneksi 4. Pyetësi përshirë dy llojet e adresave (kodi dhe emri)



POPULATION AND HOUSING CENSUS
HOUSEHOLD QUESTIONNAIRE (FORM R2)
Census Law No. 03/L-237 "Kosovo Official Gazette", no.84/2010
 All the data in this questionnaire are protected by law and will be used only for statistical purposes.



Municipality

Settlement

EA

Building No.

Entrance No.

Dwelling No.

Household No.

Address: Municipality, Settlement, Street, Building no., Entrance no., Dwelling no.

LIST 1 - HOUSEHOLD MEMBERS (PERSONS USUALLY RESIDENT IN THE DWELLING)

Person no.	Name	Surname	Father's name; for married and widowed women, husband's name	Sex 1 M 2 F (a)	Date of birth (dd/mm/yyyy)	Relationship to the head of household	Ordinal number of the family	Family status
1	2	3	4	5	6	7a	7	8a
01						HEAD OF THE HH	01	
02								
03								
04								
05								
06								
07								
08								
09								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
16								
17								
18								
19								
20								

TOTAL NUMBER OF PERSONS

MALES

FEMALES


(a) 1 Male
2 Female

Head of household/Respondent


Name and Surname _____

Signature: _____

Aneksi 5 Shembull i hartës GIS për të siguruar mbledhjen e saktë të adresave sistematike



Aneksi 6 Shembull praktik me GIS



Aneksi 7 Shembull i "Profil i komunave"

